



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

NJOFTIM

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE
PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Lloji i diplomës "Shkenca Juridike/ Shkenca Sociale/ Shkenca Politike/Shkenca Shoqërore/ Shkenca Ekonomike ", niveli minimal i diplomës "Master Profesional"

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi** shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

- 1. Specialist i Pritjes së Ankesave në Zyrën Rajonale në Shkodër -Drejtoria e Pritjes së Ankesave- Kategoria: IV-2**

Pozicioni i më sipërmë, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE

24.11.2024

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

29.11.2024

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Zbaton planin dhe udhëzimet e eprorit për zhvillimin korrekt dhe në përputhje me dispozitat ligjore të Zyrës së Komisionerit për pritjen e ankesave, ku përfshihen kryesisht organizimi i pritjes së ankuesve, sistemimi i ankesave, dhënia e përgjigjeve të menjëhershme në afatin ligjor etj.
2. Zbaton planin e drejtorisë lidhur me publikimin dhe shpjegimin e të drejtave për mbrojtjen nga diskriminimi dhe publikimin periodikisht të veprimtarive të zhvilluara.
3. Pranon dhe regjistron ankesat që paraqiten pranë Institucionit të Komisionerit dhe ndihmon me këshilla juridike ankuesin në plotësimin e formularit të ankesës. Ata që nuk janë në gjendje të paraqesin një ankesë me shkrim, lejohen ta paraqesin atë me gojë. Në këtë rast, Specialisti mban procesverbal.
4. Kontaktimi i ankuesve për plotësimin e ankesave sipas përcaktimeve ligjore
5. Jep përgjigje të gjitha kërkesave të paraqitura për informacion pranë Zyrës së Komisionerit nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë me publikun ose në rrugë elektronike, postare, nëpërmjet telefonit etj.
6. Nëse ankesa e paraqitur nuk hyn në juridiksionin e institucionit, ndihmon me këshilla juridike në mënyrë që të drejtohen në organin kompetent.
7. Nëse ankesa nuk është e plotë ose paraqet paqartësi, jepet mundësia e plotësimit ose e përsëritjes edhe njëherë e saj.
8. Në fund të çdo muaji dorëzon evidencën e ankesave tek eprori, shoqëruar me një relacion shpjegues për problemet që kanë rezultuar.
9. Sipas udhëzimeve të eprorit, merr të gjitha masat e duhura për marrjen nga ana e ankuesit, në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë të informacionit të kërkuar.
10. Me porosi të eprorit merr pjesë në grupe pune studimore ose tematika të ndryshme që i interesojnë kësaj drejtorie dhe Zyrës së Komisionerit.
11. Merr pjesë në seancat dëgjimore publike që zhvillohen nga Komisioneri ku ftohen palët dhe çdo person tjetër i interesuar në çështjet e ngritura për shqyrtim dhe mban procesverbalin e seancës, në rast pamundësie të specialisteve të Drejtorisë Juridike.

LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar brenda së njëjtës kategori (ekzekutive);
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni)
- c- Të kenë të paktën dy vlerësimet e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- “Master Profesional” në Shkenca Juridike/ Shkenca Ekonomike/ Shkenca Sociale/ Shkenca Politike/ Shkenca të Komunikimit/Shkenca Shoqërore.
Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- b- Të ketë përvojë pune jo më pak se 1 (një) vit në nivel ekzekutiv, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura. Përbën avantazh eksperiencia e punës në një pozicion të ngjashëm , me atë të kërkuar.
- c- Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze dhe një gjuhë të dytë të BE-së.
- d- Të ketë kualifikime në fushën e të drejtave të njeriut ose në shoqërinë civile.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Aktin e emërimit si nëpunës civil.
- h - Vlerësimet e fundit nga eprori direkt;
- i - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Kandidati duhet të dorëzoje me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, pranë Protokoll/Arshivës (Rruga Durrësit, Nr.27, Tiranë [Tel:+355 4 2431078](tel:+35542431078) e- mail: www.info@kmd.al dokumentat e sipërpërmendur):

Dokumentat për procedurën e lëvizjes paralele duhet të dorëzohen me postë ose drejtpërdrejt brenda datës: 24.11.2024

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **26.11.2024**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, do të shpallë në portalin “Agjencia Kombetare e Punësimit dhe Aftësive”, në stendën e informimit të publikut dhe në faqen zyrtare të KMD-së, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 3 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuri mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë ;
- Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"; i ndryshuar
- Ligjin nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", *i ndryshuar* .
- Ligjin nr.9131, date 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike; Ligji nr.214/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit ".
- Ligjin nr. 8517, date 22.07.1999 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Ligji nr. 9367, date 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", *i ndryshuar*.
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe të protokolleve shtesë të saj.
- Ligj nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”
- Ligjin nr. 9970/2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i vënë për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi(www.kmd.al), në stendën e informimit në KMD-së si dhe portalin “Agjencia Kombetare e Punësimit dhe Aftësive”

2 PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si dhe portalin “Agjencia Kombetare e Punësimit dhe Aftësive”

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

a- “Master Profesional” në Shkenca Juridike/ Shkenca Ekonomike/ Shkenca Sociale/ Shkenca Politike/ Shkenca të Komunikimit/Shkenca Shoqërore.

Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

b- Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze dhe një gjuhë të dytë të BE-së.

c- Të ketë kualifikime në fushën e të drejtave të njeriut ose në shoqërinë civile.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g- Vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që aplikanti nuk ka masë disiplinore në fuqi.

h- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Kandidati duhet të dorëzoje me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, pranë Protokoll/Arshivës (Rruga Durrësit, Nr. 27, Tiranë Tel:+355 4 2431078.

e- mail: www.info@kmd.al dokumentat e sipërpërmendur):

Dokumentat për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të dorëzohen me postë ose drejtpërdrejt brenda datës: 29.11. 2024

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **09.12.2024**, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga njësia e burimeve njerëzore të KMD-së, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë anakesë pranë Njesisë Përgjegjëse brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës së kandidatëve të kualifikuar. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të ankesës.

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuri mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë ;
- Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"; i ndryshuar
- Ligjin nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", *i ndryshuar* .
- Ligjin nr.9131, date 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike; Ligji nr.214/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit ".
- Ligjin nr. 8517, date 22.07.1999 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Ligji nr. 9367, date 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", *i ndryshuar*.
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe të protokolleve shtesë të saj.
- Ligj nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”
- Ligjin nr. 9970/2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të shpallë fituesin në faqen zyrtare si dhe portalin “Agjencia Kombetare e Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen zyrtare të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe portalin “Agjencia Kombetare e Punësimit dhe Aftësive” për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si dhe portalin “Agjencia Kombetare e Punësimit dhe Aftësive” duke filluar nga data 09.12.2024.

Njësia Përgjegjëse